


2 Vendime të aprovuara në mbledhjen e XI-të (Njëmbëdhjetë) të Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 24 Dhjetor 2020;

1. Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 104/02-12812/2018 të datës 27.04.2020 – Për formimin e Komitetit për Shërbime Publike / Lënda: 01Nr. 104.02-29811/20 ; dhe
2. Vendimin për aprovimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2021/ Lënda: 01Nr. 060/01-29866/20.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-29811/20
Kaçanik, 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 51.2 të Ligjit nr. 03/L-040-për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 10 A pikat 1,2 dhe 3 të (MAPL) Nr. 02/2018 për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, Kuvendi i Komunës Kaçanik që në mbledhjen e mbajtur me 24 Dhjetor 2020, të mori këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL 01 NR. 104/02-12813/2018 TË DATËS 27.04.2018- PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE

1. Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit Komunal 01 NR. 104/02-12813/2018 të datës 27.04.2018, për formimin e Komitetit për Shërbime Publike (KSHP).
2. Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet tek pika 2 e vendimit, paragrafi 5, ashtu që:
 - 2.1 Ish Anëtarja e KK, Afërdita Shehi (Horuni) nga AAK e cila ishte edhe anëtare e KSHP, pas dorëheqjes nga pozita e anëtares së Kuvendit të Komunës, me automatizëm i ka pushuar edhe pozita e anëtares në KSHP.
 - 2.2 Në Komitetin për Shërbime Publike në vend të saj, caktohet për anëtar, **Kjani Sallahu**, përfaqësues i jashtëm nga OJQ/ Shoqëria Civile.
3. Me Ndryshim plotësimet e bëra me këtë Vendim, Komiteti për Shërbime Publike ka këtë përbërje:

1. Hamid Guri,	PDK	anëtar;
2. Lirije Shurdhani(Dema)	PDK	anëtare;
3. Adnan Reka	LVV	anëtar;
4. Arlinda Rakoci-Raka	LDK	anëtar; dhe
5. Kjani Sallahu	OJQ/ Shoqëria Civile	anëtar.
4. Ndryshim plotësimet bëhen për shkak së me UA të përcaktuar si në bazën juridike, ky komitet duhet të përfaqësohet edhe me anëtarë të jashtëm. Arsytimi është dhënë nga Kryetari i Komunës i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Pikat tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Vendimi u dërgohet: Anëtarët e KSHP; Kryetarit të Komunës; Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01-104/02-29811/20

Në mbështetje të nenit 58 pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6 pika b dhe h të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut:

Propozon

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokales si dhe duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, që në mbledhjen e radhës të datës _____ të merr këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL 01 NR. 104/02-12813/2018 TË DATËS 27.04.2018 PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE

1. Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet vendimi i Kuvendit Komunal 01 NR. 104/02-12813/2018 të datës 27.04.2018, për formimin e Komitetit për Shërbime Publike.
2. Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet tek pika 2 e vendimit, ashtu që:
 - 2.1 Komiteti për Shërbime Publike përbëhet prej pesë anëtarëve nga radhët e Kuvendit të Komunës, duke reflektuar përfaqësimin politik në Kuvend zëvendësohet me:
 - 2.1.1 Komiteti përbëhet prej pesë anëtarëve nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit jashtë kuvendit.

2.2 Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhen edhe në paragrafin 2.5 të vendimit ashtu që:

2.2.1 Anëtarja Afërdita Shehi nga AAK, zëvendësohet me anëtarin- përfaqësuesin jashtë kuvendit Kjani Sallahu.

3. Pikat tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Arsyetim

Për shkak se ish anëtarja e Kuvendit Komunal Afërdita Shehi nga radhët AAK ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarës të kuvendit, e që nënkupton se ajo lirohet nga të gjitha përgjegjësit e tij të cilat i kishte si dhe lirohet po ashtu edhe nga të gjitha komitetet në të cilat ishte anëtare. Kështu për të njëjtën arsye nuk mund të jetë anëtare e Komitetit për Shërbime Publike.

Në Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, në nenin 10 B pika 1 thuhet qartë se Komiteti përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit jashtë kuvendit, prandaj si përfaqësues jashtë kuvendit është caktuar me propozim të datës 26.11.2020 nga Forumi i Organizatave Joqeveritare të Kaçanikut anëtar i këtij forumi Kjani Sallahu.

Vendimi u dërgohet:

1. Kryetarit të Komunës,
2. Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
3. Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit
4. Anëtarëve të Komisionit, dhe
5. Arkivit.

**Kryetari i Komunës
Besim Ilazi**





FORUMI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE TË KAÇANIKUT



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	26.11.20	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
	01-104	/02- 29687	/20	

PËR: KRYETARIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT, z. BESIM ILAZI

NGA: FORUMI I OJQ-ve të KAÇANIKUT

PROPOZIM PËR PËRFAQËSIM NË KOMITETIN PËR SHËRBIME PUBLIKE

I nderuar kryetar, Besim Ilazi!

Në përputhje me kërkesën tuaj për përfaqësimin e shoqërisë civile në Komitetin për Shërbime Publike të Komunës së Kaçanikut, ju konfirmojmë se KSHP-në do ta përfaqësojë Kjani Sallahu.

Delegimi i përfaqësuesit të sipërpërmendur bëhet konform Statutit të Forumit të OJQ-ve të Kaçanikut, përkatësisht nenit 2.2 të këtij statuti.

Kaçanik
25.11.2020



FOJK – Kaçanik
Shemsedin Abazi

Shemsedin Abazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 060/01-29866/20
Kaçanik, 24.12.2020

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2(d) lidhur me nenet 40.1 dhe 40.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 04 Qershor 2008), të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës Kaçanik, mbledhjen e vet të mbajtur me 24 Dhjetor 2020, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL PËR
SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2021

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani 01 Nr. 060/01-29866/20 më tekstin e mëtejme: “Plani Vjetor i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2021” i hartuar nga KKSB.
2. Plani i Punës si në pikën 1. të këtij Vendimi përmban; pikësynimet në lidhje me objektivat nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të KKSB, nivelin e realizimit të tyre, dhe numrin e takimeve për gjatë vitit 2021.
3. Plani i Punës së KKSB, përmban gjithsej 5 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohet: Zyra e Kryetarit të Komunës(përmes saj njoftohen anëtarët e KKSB), dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	01.12.20	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01	060/01-29866	✓	

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

PLANI VJETOR I PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL TË SIGURISË NË BASHKËSI, PËR VITIN 2021

HYRJE

Plani Vjetor i Punësi KKSBS-së përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSBS-së, në përmbushje të qëllimit të funksionimit të KKSBS-së. Plani efektiv i punës ka për bazë strategjinë komunale për përafrimin e objektivave dhe burimeve.

Ky plan i punës synon të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësisë për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrativ të KKSBS-së.

KKSBS nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e caktuara në PVP-së, por do të jetë aktive dhe në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, për t'i identifikuar dhe adresuar problemet e qytetarëve nga fusha e sigurisë së përgjithshme si dhe përçimin e kërkesave të kësaj natyre.

Po ashtu, KKSBS do të krijojë raporte të rregullta me Kuvendin e Komunës dhe të kërkojë nga legjislativi lokal mbështetjen e funksionimit të KKSBS-së, sikundër edhe përkrahjen e iniciativave dhe projekteve konkrete në të mirë të sigurisë së qytetarëve. KKSBS do të monitorojë trajtimin nga Komuna të rekomandimeve që dalin nga ky këshill.

PËRBËRJA E KKSBB-së

	Emri e mbiemri	Përfaqësimi	Telefoni	E-mail adresa
1	Besim Ilazi Kryesues i KKSBB-së	Kryetar i Komunës	0290 380005 044 116 133	besim.q.ilazi@ks-gov.net
2	Halim Shehu	Komandanti i Stacionit të Policisë në Kaçanik	0290 380 834 044 219 530	halim.shehu@kosovopoliice.com
3	Fidaim Fazliu	Këshilli i Bashkësisë Islame – Kaçanik	0290 380 076 044 887 455	fidaim.fazliu.1@gmail.com
4	Lirije Luta	Komiteti për Komunitete	044 824 768	lira22@live.com lirije.qeli@rks-gov.net 16.
5	Vedat Dema	Zyra per Barazi Gjimore	044 279386	vedat.dema@rks-gov.net
6	Zahir Doda Koordinator	Drejtore i DAK-së	044 225 351	zahir.doda@rks-gov.net
7	Jashar Selimi	Këshilli i Prindërve	046 164 799	jasha888@hotmail.com
8	Fiton Kastrati	Forca e Sigurisë së Kosovës	049 902 724	fiton.kastrati@fsk-rks.org
9	Shemsedin Abazi	Këshilli Lokal për Siguri Publike	044 224 685	shabazi@hotmail.com
10	Fatmir Çaka Procesmbajtës	Ekipi Vepruese për Siguri në Bashkësi	044 346 157	fatmirqaka@hotmail.com
11	Ramadush Osmani	Spektori i Emergjencave Civile	044 414 303	ramadush.osmani@rks-gov.net
12	Fadil Guri	Zyra për Kthim dhe Komunitete	044 228 115	fadil.guri@rks-gov.net
13	Remzi Reka	OJQ-të, Mediet, Bizneset, PAK-të	045 537 873	remzisreka@gmail.com

ORARI I TAKIMEVE TË KKSBB-së - 2020

	Periudha	Koha	Vendi	Rendi i punës	Pjesëmarrja
1	22-29 janar 2021	11:00	Salla e madhe KK-së	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Gjendja e rrugëve dhe mirëmbajtja dimrore 4. Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSBB-së, gjatë vitit 2020 5. Informatë e Shtabit Emergjent për situatën eventuale pandemike COVID-19 6. Të ndryshme	Anëtarët e KKSBB-së Inspektorët komunalë
2	05-12 Mars 2021	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Identifikimi në terren dhe prezantimi i problemeve urgjente të sigurisë 4. Informatë për punën e inspektorëve komunalë 5. Të ndryshme	Anëtarët e KKSBB-së
3	22-29 Prill 2021	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Inicimi dhe përzgjedhja për realizimin e një projekti të sigurisë 4. Të ndryshme	Anëtarët e KKSBB-së
4	09-16 Qershor 2021	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Trajtimi i ambientit dhe menaxhimi i mbeturinave gjatë stinës së verës 4. Të ndryshme. Përgatitja për sfidat eventuale gjatë sezonit veror (zjarret, trafiku i automjeteve...)	Anëtarët e KKSBB-së Shefi i njësisë së KRM "Pastërtia" – Kaçanik OMM "Gjethi" Kompania "Krasniqi"
5	06-13 Gusht 2021	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Trajtimi i ankesave të qytetarëve për sigurinë 4. Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës, për vitin 2022 5. Të ndryshme	Anëtarët e KKSBB-së Komisioni i Ankesave
6.	14-21 Shtator 2021	11:00	Salla e vogël	1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar 2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut 3. Përgatitja e përbaljes me sfidat me kushtet klimatike dimrore 4. Aprovimi i Planit Vjetor të Punës 2022 5. Të ndryshme	Anëtarët e KKSBB-së

OBJEKTIVAT E KKSb-së NË PVP 2021

Plani Vjetor i Punës së KKSb-së është orientues dhe jo domosdoshmërisht do të kufizohet vetëm në pikat e sipërpërmendura. Ky këshill do të trajtojë edhe tema të tjera, varësisht nga kërkesat dhe zhvillimet gjatë këtij viti. Në përputhje me nenin 11, paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ të KKSb, kjo e fundit mund të mbajë edhe takime të tjera, varësisht nga nevojat e paraqitura në ndërkohë.

TAKIME TË JASHTËZAKONSHME - VARËSISHT NGA ZHVILLIMET

KKSb do të interesohet edhe në kërkimin e donatorëve të brendshëm e të jashtëm për zbatimin e projekteve konkrete në lëmin e sigurisë, fushata vetëdijesuese, etj.

KKSb do të shqyrtojë edhe çështje të tjera të cilat ndërlidhen me objektivat, detyrat dhe kompetencat e këtij organi konsultues:

- Trajtimi i situatës pandemike COVID-19
- Trajtimi i performances dhe rekomandimi për aktivitet më ekspeditiv të inspektorëve komunalë
- Trajtimi i ekstremizmave të ndryshëm eventuale
- Iniciativat e përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë
- Përfaqësimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të gjithë qytetarëve, për çështjet që lidhen me sigurinë e jetës së tyre
- Zhvillimin e projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi
- Identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike
- Bashkëpunimin me strukturat e sigurisë në parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi
- Informimin e Kuvendit Komunal dy here brenda vitit për aktivitetet e KKSb-së

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi në komunën e Kaçanikut, edhe gjatë vitit 2021 do të jetë në funksion të realizimit të objektivave, konform rolit dhe kompetencave që ka. Ndër objektivat e KKSb-së, më me përkushtim do të trajtohen:

- Identifikimi i problemeve që cenojnë sigurinë e qytetarëve
- Inicimin e zgjidhjeve të problemeve që kërcënojnë sigurinë publike dhe jo vetëm
- Thirrje për vetëdijësimin e qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve
- Parandalimi i veprimeve të dhunshme
- Rekomandimin e planeve të veprimit dhe adresimi i shqetësimeve të qytetarëve te institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive të komunës së Kaçanikut

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi poashtu, do të ofrojë mundësinë për adresimin e gjerë të problemeve me të cilat mund të përballen qytetarët, siç janë: siguria në shkollë, e cila mund të trajtohet në nivelin lokal përmes koordinimit të organeve të shkollës, prindërve, mësimdhënësve, Drejtorisë së Arsimit, drejtorive komunale përkatëse, policisë dhe akterëve të tjerë.

KKSb-së do të trajtojë ide, plane, propozime, sugjerime dhe projekte konkrete për fushën e sigurisë publike dhe jo vetëm.

Ky organ konsultues komunal, do të diskutojë edhe tema të tjera që ndërlidhen me veprat penale e kundërvajtëse, me theks të veçantë: përdorimin e armëve nëpër ahengje familjare dhe organizime të ndryshme, sigurinë në komunikacion, përhapjen e zjarreve, prezencën e qenëve endacakë dhe rrezikun e shumfishtë nga kjo kafshë pa pronar, përdorimin e substancave narkotike nga të rinjtë, sigurinë në shkolla, mbeturinat në rrugë e në hapësira publike, vjedhjet individuale dhe të organizuara, prishjen e qetësisë publike, lirimimin e hapësirave publike për sigurinë e lëvizjes së qytetarëve, sigurinë e lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e ambientit, sigurinë higjienike e sanitare të hapësirave të cilat frekuentohen dhe shfrytëzohen nga qytetarët, sigurinë e konsumatorëve nga produktet ushqimore, etj.

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi, siç është përmendur edhe më lart, do të insistojë në kërkesat e donatorëve dhe institucioneve lokale, për financimin e projekteve konkrete të cilët do të implementohen nga qeveria komunale.

Projektet më me prioritet, disa prej të cilave vazhdojnë që disa vite t'i prijnë listës, janë:

- Fushatë vetëdijësuese për mbrojtje nga koronavirusi COVID-19
- Trajtimi i dukurisë së vjedhjeve dhe dukurive të tjera të cilat e dëmtojnë qytetarin e komunës së Kaçanikut
- Rregullimi i infrastrukturës fizike (pjerrinave, ashensorëve, shkallëve emergjente) nëpër institucione
- Ndërtimi i trotuareve për sigurinë e qytetarëve në lokalitetet në të cilat mungojnë ato
- Vendosja e kamerave të sigurisë në institucione dhe në hapësira publike
- Vendosja e pengesave (policëve të shtrirë) nëpër lokacione urbane e jurbane, sidomos afër shkollave
- Vendosja e hidrantëve publik nëpër rrugët kryesore të qytetit, për përgjigje të shpejtë dhe efikase ndaj përhapjeve eventuale të zjarreve
- Largimi i deponive të egra
- Parandalimi i huliganizmit nëpër shkollat e komunës
- Luftimin e narkomanisë dhe dukurive tjera negative
- Adresimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve

Plani i punës i KKS-së do të zbatohet në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe 03/2012 të MAPL-së dhe si i tillë, nga anëtarët e KKS-së i përcillet për miratim KK të Kaçanikut.

Kaçanik,
22.11.2020

Grupi Punues i PVP-së:

Zahir Doda

Kjani Sallahu

Lirije Luta

